

VENDIM
Nr. 66, datë 11.5.2017

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
SHOQËRISË “ALB ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 56, datë 18.4.2017, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, geramat:
 - “a” - ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;
 - “b” - veprimtaria e licencuar, është plotësuar;
 - “c” - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është plotësuar;
 - “d” - përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;
 - “e” - arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;
 - “f” - efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;
 - “g” - efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;
 - “h” - marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;
 - “i” - deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;
 - “j” (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është plotësuar;
- Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a. (lista bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit

të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ASETET QË SHOQËRIA “ALB ENERGY” SH.P.K. KA KËRKUAR TË LËRË PENG NË
FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA

a) Certifikatë nr. 548628; përshkrimi i pasurisë:

Hec “BELE 2” disponon ndërtesën me $S = 609 \text{ m}^2$,

Tubacion 1502 m

Vepra e marrjes sip=235 m^2

Sipërfaqe trualli =16.594 m^2 ,

b) Certificate nr. 548626; përshkrimi i pasurisë:

“Hec Topojan 1” disponon ndërtesën $S = 372 \text{ m}^2$,

Tubacion 1502m

Sipërfaqe trualli, $S = 4641 \text{ m}^2$,

c) Certifikatë nr. 548650; përshkrimi i pasurisë:

Nënstacion, $S = 932 \text{ m}^2$